

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– Departamenti për Krime të Rënda**, trupi gjykues në përbërje prej gjykatësit Xhevdet Elshani kryetar dhe gjykatësve Fatmir Krasniqi e Luan Berisha, anëtarë, me sekretaren juridike Afërdita Buqaj, punëtore e kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit N. B., i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren me aktakuzën e tyre PP.nr. 296/2015 të datës 29.01.2016 për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par 1 nën par 1.3 të KP të Kosovës dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 nën par 4.2 lidhur me par 2 të KP të Kosovës, në shqyrtime kryesor jo publike të mbajtura me data 19.08.2016, 30.09.2016, 07.11.2016, 29.11.2016, 20.12.2016, 21.03.2017, 11.04.2017 (monitoruar nga OSBE, EULEX, BIRN, IKD etj) dhe seancës së këshillimit dhe votimit më datë 12 prill 2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehdi Sefa, të akuzuarit N. B., mbrojtësit të tij avokat E. G., të dëmtuarës E. B. e pjesëmarrësve tjerë pas seancës së këshillimit dhe votimit me datë 12. Prill 2017 mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. B.**, nga i ati I. dhe e ëma V. e lind. M., i lindur më *data e lindjes...* në S., me banim të përhershëm në S. Rr... nr. ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar – babë i katër fëmijëve, shqiptar – shtetas i R së Kosovës, gjendet në paraburgim prej datës 13.10.2015.

## Ë S H T Ë F A J T O R

**1.**Se me datë 23. 10. 2015 rreth orës 21:25 minuta në S., në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën .... me dashje privon nga jeta anëtarin e familjes bashkëshorten Z. B. në atë mënyrë që pas një bisede dhe mosmarrëveshje paraprake lidhur me do telefonata që i merrte bashkëshortja e tij për të cilat besonte se kanë të bëjnë me tradhti bashkëshortore, deri sa viktima Z. B. ishte në dhomën e ndejës dhe bisedave rreth kësaj çështje, me një thikë të gjatësisë së tehut 10.5 cm, e gjerësisë 2.5 cm e sulmon bashkëshorten me thikë duke i shkaktuar njëzetë ( 20) plagë, prej tyre dymbëdhjetë ( 12) plagë kanë qen depërtuese, shtatë ( 7 ) goditje ka pësuar në zgavrën e majtë të kraharorit dhe pesë ( 5 ) goditje në zgavrën e barkut, vajza e tyre e mitur E. B. pas britmave të nënës hyn në dhomën e ndejës dhe sheh se babai N. B. është duke e goditur me thikë nënën Z., i afrohet ta mbrojë nënën duke vendosur dorën e djathtë në trupin e nënës me këtë rast e godet me thikë në dorë edhe të dëmtuarën E. B., me ç rast nga plagët e marra e ndjera Z. B. vdes në vend si pasoj e gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme nga dëmtimi i mushkërisë së majtë, mëlçisë, shpretkës, majës së zemrës, të gjitha këto plagë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë dhe me maje, më për së afërmi e përshkruar si në raportin e autopsisë të dt. 25.10.2015 të ekspertit mjeko – ligjor dr. S. F. B., ndërsa të dëmtuarës vajzës E. B. i shkaktën lëndime të lehta trupore në regjionin e shuplakës të dorës së djathtë – në gjendje të përgjegjshmërisë penale të zvogëluar,

-kësodore kryen veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par 1 pika 1 .3 lidhur me nenin 18 par 2 të KP-së, dhe

2. Se me datën, kohën dhe vendin e njëjtë i akuzuari i shkakton lëndim të lehtë trupor vajzës së mitur të dëmtuarës së ndjeshme E. B. me një mjet të rrezikshëm dhe të mprehtë me të cilën mund të shkaktohet lëndimi i rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit në atë mënyrë që pas britmave të nënës Z. E. hyn në dhomën e ndejës dhe sheh se babai N. B. është duke e goditur me thikë nënën Z., i afrohet ta mbrojë nënën duke vendosur dorën e djathtë në trupin e nënës me këtë rast i akuzuari N. e godet me thikë në shuplakën e dorës së djathtë duke i shkaktuar plagë prerëse e cilësuar nga eksperti mjekoligjor dr. M. G. të dt. 28.01.2016 së lëndimi i lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin-në gjendje të përgjegjshmërisë penale të zvogëluar,

- kësodore kryen veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 nën par 4.2 lidhur me par 2 të KP të Kosovës.

Prandaj gjykata në mbështetje të neneve 45, 69, 73 par 3 pika 3.1, 76 par 1 pika 1.1, 80 par 3 pika 7.2 e lidhur me nenin 18 par 2 të KPK dhe nenin 365 të KPP, të akuzuarit N. B. i

### **sh q i p t o n**

1.Dënimin me burg prej 12 ( dymbëdhjetë ) vitesh për veprën penale vrasjes e rëndë nga neni 179 par 1 pika 1.3, dhe

2.Dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 ( një ) viti për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 2 të KPK.

Me aplikimin e dispozitave të nenit 80 të KPK mbi shqiptimin e dënimit unikë, gjykata të akuzuarin , e

### **G J Y K O N**

Me dënim unikë burgimi në kohëzgjatje prej 12 ( dymbëdhjetë) vite e 6 ( gjashtë) muaj, në të cilin do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.10.2015 deri më datë 12.04.2017.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet

### **DËNIMI PLOTËSUES**

Ashtu që prej tij merret thika si mjet i kryerjes së veprave penale.

Ndaj të akuzuarit vazhdohet paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 700 ( shtatëqind ) euro në afat prej 15 dite prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren me aktakuzën e tyre PP.nr. 296/2015 të datës 29.01.2016 kanë akuzuar N. B. nga S. për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par 1 nën par 1.3 të KPK dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 2 të KPK.

Prokurori sikurse në fjalën hyrëse gjatë shqyrtimit gjyqësor po ashtu edhe në fjalën përfundimtare në tërësi ka ngel pranë aktakuzës me propozim që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

E dëmtuara E. B. e kujdesur nga zyrtarja për mbrojtjen e viktimave Sh. S., në tërësi kanë mbështetur fjalën e Prokurorit, nuk kanë parashtruar kërkesë pronësore juridike.

E dëmtuara E. B. ka dëshmuar në prezencë të dr. N. F.- psikiatër: se babai atë ditë ka qenë në shtëpi, tan ditën ka konsumuar alkool deri në mbrëmje ai ka konsumuar alkool në sallon dhe sa më kujtohet ka thirr me telefon burri i tezes S. P. dhe ka shpreh dëshirë që të vjen si mysafirë, atëherë ai ka thënë okej eja, dhe pas nja 5 min babai i tha mos hajde se nuk jam në gjendje me pranë musafirë. Kur jam kthyer në shtëpi prej shkollë në ora 18:40 babai vetëm ecte dhe mendojke, ndërsa mami ka qenë në shup dhe e përshëndeta mamin dhe pyeta se ku është babi e ajo më tha se është në sallon dhe më tha të shkoj dhe ti them mirëmbërëma, ai nuk ma kthej përgjigjen ishte në gjendje të dehur. Kah ora 19:00 mami ka hy në sallon dhe babai na ka mbledh të katër fëmijët dhe nënën bashkarisht dhe ka fillu me na tregu për marrën që paska bë ajo. Ai ka menduar se mami është duke e tradhtuar, atëherë ne fëmijët kemi reagu, babë nana ka bë katërdhjetë vjet, gjashtëmbëdhjetë vjet na ka shiku, atëherë babai tha ju nuk dini, dhe mbeti në sallon me mamin, pasi neve fëmijët kemi shku në dhomën tjetër dhe jemi ba gati me flejt. Atëherë babi flejke në sallon, mami erdh në dhomën tjetër me marr teshat e me ja shtru babit, motra i tha mamin natën e mirë, babai ishte në banjo, dhe motra ka hy në dhomën tjetër e babai në sallon e mami ka qenë në sallon duke i përgatit kafën. Vetëm sa jemi shtri kemi ndëgjuar mamin duke bërtitur, të katërt jemi ngritur dhe jemi drejtuar kah salloni, motra e dytë e ka hap derën dhe kur e ka pa mamin në atë gjendje nuk ka hy. Unë pastaj kam hy e ajo ka ndejt te dera, dhe kam vërejtur babin duke goditur mamin me thikë në shtratë e cila ka qen e shtrir në shtrat, jam ofruar dhe kam bërtitur : o babë çka je tu bo, fjala e fundit e mamin ka qenë : O ma mos më mësho, unë e kam shty babin e ai sërish është vërsulur në mamin e atëherë unë dorën e djathtë e kam lënë në bark të mamin e atëherë ai ka goditur dhe thika i ka ra në kauç. Kur e kam zgjat dorën me marr thikën ai e morri thikën dhe doli jashtë, ndërsa unë kam qenë e plagosur në dorë gjë që as nuk e kam pa e as që e kam ndie. Pastaj e kam marr mamin duke tentuar që të përcjelli në ordinanc të G. B. pasi është shumë afër.

I akuzuari N. B. që prej fillimit të kësaj procedure penale në tërësi ka pranuar veprimet kryese që i përbëjnë veprat penale që i ngarkohen me aktakuzë. I akuzuari ka theksuar se me datë 20.10.2015 kam dal si zakonisht me shku në punë pse kam qenë në ndërrimin e natës te Sh. S. dhe ai ka punuar për nevojat e Bectel-enka, atë ditë ka ra shi tan ditën. Unë si zakonisht kam dal në ora katër pas dite dhe jemi taku për çdo ditë me kolegët në kafeterin “...” në afërsi të objektit të Policisë dhe më thirri mua djali i shefit K. S. dhe më tha : “ tregoi të tjerëve se sot nuk do të punohet se është koha me shi”. Aty kemi ndejë nja 10-15 minuta. Kemi pi nga një kafe e pastaj kam shkuar drejt në shtëpi. Në shtëpi kam hy si zakonisht, bashkëshorten Z. e kam pa te çeshmja, afër fllanikut ku ishte duke lar diçka. Unë me shiqim të parë si u afrova te shtëpia pash se kishte ardhur

nëna e Z., nëna e saj ka jetu nëpër bija të saja dhe më shumë ka ndejt te ne, kur kam ardhur nëna e saj ka qen brenda unë nuk kam dit se ajo është brenda në shtëpi. Ajo ka pas një telefon të thjeshtë “samsung”, dhe shoqja atë telefon të nënës së saj e kam pa në fllanik mbi frigorifer dhe ka cingru deri sa unë isha aty afër dhe deri sa ka cingru një herë Z. e ndali, ende pa dal jashtë telefoni ende po cingëron dhe atëherë unë i thash pse spo e qon telefonin. Ajo e qoi telefonin dhe filloi kah drut me ec dhe kisha përshtypjen se po ik, unë atëherë 100%fillova me dyshua se ajo është duke fshehur diçka. Te drut i ka cingërua telefoni apert dhe ajo sërish e ka ndal ate, dhe kur erdh afër meje atëherë po thirr telefoni dhe unë thash hape telefonin dhe ajo ishte afër meje, dhe në vend të shtyp pultin e gjelbër ajo e preku të kuqen dhe nuk ishte duke folur me askënd dhe tha “ ... selami aleikym teta F.”, F. është motra e Z., me këto veprime të Z. pash që diçka nuk është në rregull dhe ajo tha se po ia qoj nënës me fol ajo, dhe shkoi në korridor në drejtim kah nëna e saj duke më thënë po i qoj nënës telefonin, atëherë unë dyshova dhe shkova menjëherë pas saj dhe pasi që ajo filloi të fshij numrat e telefonit dhe ka arritur të fshijë 2-3 numra por jo edhe thirrje të tjera, unë i thashë atëherë : “bjere, bjere telefonin “ e ajo më tha : “ jo kurr gjë “ dhe ajo në korridor filloi të dridhet dhe u shqetësua dhe nuk ishte në gjendje me fol dhe mendova se do ti bie të fikt. Kur e kapa telefonin ajo u mundua me shly numrin, e kapa telefonin prej dorës së saj dhe i thash pse deshte me fshi këtë numër dhe unë i thashë para nënës së saj plak duke thënë : “ ti Z. duhesh me më dhënë një shpjegim, pse u shqetësove dhe pse ke pas atë frik sikur do të bie të fikt “, vetëm kemi diskutu për këtë dhe ate pa rrahje pa sjellje të këqija. Më datë 21.10.2015 e kam thirr baxhanakun F. Th. së bashku me bashkëshorten H., F. e kam pas si vëlla dhe me te dy deri tre herë në ditë jemi taku, ate e thirra në telefon ai më tha jam i zanun jam tu pre dru, atëherë unë i thashë hajde menjëherë dhe merre bashkëshorten me vete dhe iu kam shpjegua rastin e djeshëm. Në mbrëmje kam bisedua me Z. rreth këtij numri dhe të nesërmen kam shkuar në Post dhe aty kam rrejt dhe iu kam thënë se e kam numrin e IPKOS dhe po du numrin e VALËS me qëllim që të më japin emrin e poseduesit të atij numri të telefonit, personi në post nuk më ka dhënë por më tha sa po shoh unë se është numri i policit. Me datë 22.10.2015 në mëngjese herët bashkë me Z. kam ardhur në Stacionin policor në Prizren dhe jam paraqitur tek roja dhe kam thënë po du një zyrtar me të cilin do të bisedoj për çështje të familjes dhe ai më tha shko te nr.1, kur shkova nr. 1 ishte një polic, unë tregova rastin duke thënë se kemi një mos sqarim me këtë numër dhe po na del problem rreth këtij numri dhe kemi një mosmarrëveshje në familje dhe kemi ardhur që ju me na ndihmua dhe me thirr këtë person dhe vetëm me u përballë me këtë person vetëm dy minuta. Ajo policja e morri numrin *numri i telefonit* dhe ajo tha unë e njoh këtë numër dhe ai është njeri i mirë dhe nuk ki probleme me te dhe sido që të jetë unë po e thirri dhe ajo e thirri dhe tha “mirëdita koleg, mos gabofsha tha toger “, bisedoi me te shkurt dhe i tregoi se ka ardh një person dhe po kërkon një sqarim për numrin, ku unë paraprakisht i kam qu atij një SMS që të lajmërohet me një tekst të lutem lajmërohu për një sqarim e ai më ka kthye mesazhin se “ fëmijët e kanë thirr gabimisht dhe kërkoj falje”, ajo police deshti me më ba pishman pse shkuam aty duke arsyetuar se ai është njeri i mirë dhe në rregull. Prej Policisë kam ardhur te Prokuroria bashkë me shoqen dhe në kabinë ishte një femër dhe nga ajo kërkoja të lutem dy minuta të kontaktoj me një prokuror dhe ajo morri telefonin dhe na shkroi emrin N. B. dhe Z. B. dhe e kapi telefonin thirri dikend dhe tha kështu kështu është nuk di me kënd foli, por pastaj më tha se prokurori është në D. dhe nuk mund të pranoj edhe pse unë shpreha dëshirën që të takohem me cilin do prokuror, dhe kur kam dal jashtë portës ka qen një person me tesha të sigurisë është i anës së D. , dhe ju luta atij pasi dolëm nga shkallët dhe i thashë : “ a ban vëllau im me të ba një pyetje”, e ai më tha : “ dy pyetje mundesh” i thash jam i S. dhe i thash kam një mosësqarim kam qen në Stacionin policor, erdha edhe këtu dhe kërkuh nuk më pranoi, e ai më tha : “kurrkush nuk është mbi ligjin dhe çfarëdo halli ke me polic thirre Inspektoriatin e policisë” dhe

rrugës tu shku kam hy në internet kafe te Spitali dhe pagova 50 cent dhe i thashë gjema numrin, i thirra at, fole me ta, dhe ai më tha që ne kemi hapur një zyre dhe mundesh me u anku, prej aty kemi shku në Inspektoriat dhe me shoqen kemi hy aty, aty është prezentua ai inspektor si K., dhe unë i tregova rastin atëherë shoqja doli pak jashtë, dhe me K. e kemi bisedu dhe ai më tha mos është diçka tradhti, por pasi nuk është kërcënu , dhe unë po ta marr numrin dhe për çdo rast unë të thirri. Në mëngjes të datës 23.10.2015 kam thirr bagjanakun tjetër B. Sh. dhe H. Sh. të cilët jetojnë në S. dhe iu tregova për problemin që kam me Z., e motra vet tha na nuk dim rrethe këtyre punëve dhe B. e morri numrin me që e ka dhëndrin në S. polic dhe quhej D. F.. Kam thirr djalin e bagjanakut M. L. dhe H. motrën e Z. nga fshati B., si ka shku M. me H. unë kam kuptu për këto tre ditë se edhe fëmijët kanë kuptu për rastin, ata kur kan qen mysafirët kanë shku në dhomën tjetër, unë kam qen i demoralizim dhe i shqetësuar komplet dhe kam fillu me pi në shtëpi dhe ate kam fillu me pi prej orës 10:00 dhe nuk di sa ka zgjat pija nuk kisha përdor alkool shtatë vite deri sa kam pa veten kah ora 19:00 shoqja ime Z. ka fillu me më tregu se kush është ai person por paraprakisht kam bisedu me bagjanakun S. P. nga fshati D. i cili më thirri me telefon dhe më tha nesër po shkojmë për P.. Atëherë ai ka qen momenti i fundit kur shoqja kuptoi se do të del realiteti në shesh se me kënd është ajo duke bisedu me telefon dhe atëherë më tha: hajde shoqi im ata gjinja kan ba kumedit çka e na burrë e gru mundemi me bisedu lirshëm “ e unë i thashë : “ po qesmi çka ka mashkulli dhe femra që qesim në tavolinë dhe pse unë Z. e kam ditë edhe më herët se ajo është e përlyt por unë e kam dash atë”, me që kam pas katër fëmijë e me to unë çata jashtë nuk kam mujt me gjujt dhe kam dashtë me përballu të gjitha ato që ka bërë ajo me tjerët se me pas dash diçka me bo asaj unë kisha bo asaj me datë 20.10.2015 qysh para tre dite. Ajo filloi mem tregu se polici me të cilën kam bisedua me telefon quhej B. dhe është nga S. (identiteti i njohur nga i akuzuari dhe palët për këtë person), dhe është me grad në polici, dhe kur kemi pas problem unë me Z. ai ka shfrytëzua rastin duke i thënë : “ mos shko në polici por thirre ate për çkado send unë përgjigjna”, atëherë unë i thashë : “kallëxo drejt a më ke tradhtua me te “. Ajo më tha :” Po kam pas marrëdhënie me te në një banesë në S. “ atëherë filloi dorën me ma qit mem relaksua në momentet e fundit që unë këto mos me marr si tragjike, atëherë unë e pash veten që filloi një lloj shqetësimi me më ardh nga pjesa e poshtme te nalt, dhe kisha ni ndjenj të keqe dhe i thash : “ kah qysh”, atëherë më tha : “ mos më ngushto më shumë se shumë të kam kallxu “.

Katër javë kam punu natën veq dy javë ditën, ajo më ka thirr ndonjëherë natën kur kam punu duke më pyetur “qysh je a po lodhesh “.

Unë kam vazhduar me pyet a ka qen B. ndonjë herë në shtëpinë tonë”, ajo më tha po: “ ka qen një herë “ dhe kemi bë marrëdhënie me te vetëm shokë e përpjetë”. Atëherë unë e pash veten që spo muj me përballu dhe i thashë qitma një kafe, atëherë ajo filloi të më prek me dorë me qëllim që të më qetësoi pasi më pa se isha i shqetësuar dhe u qu i ka qit kafet, kuzhina është në anën e djathtë e unë kam qen në kauç në mes, me që unë non – stop birrat i kam mbajt në fllanik-në frigorifer të vogël tek akulli dhe ajo kish zi kafet dhe sekondi i fundit kur e kam pa tu qit kafen prej xhezves së kuqe, dhe prej asaj sekondi nuk di apsolutisht asgjë, dritarja ka qen te vitrina dhe mua mu ka duk se dritarja po qilet dhe unë prej alkoholit kam pas parafytyrime se ajo po qel dritaren atij policit dhe dul polici dhe ia qiti duart në pjesën prapme posht belit dhe apsolutisht asgjë nuk më kujtohet e di veten kur e kam pa jashtë shtëpisë i rrethum me drita, kam pa fëmijët tek dyert e shtëpisë, e kam pa thikën në dorë nuk më kujtohet ku e kam marr po edhe kam dal jashtë dyerve punë shtëpi dhe nuk kam dit ku kam dasht me shku, por e di rrugën ... dhe ka mundësi që jam nis kah qajo rrugë ku kam shku çdo ditë në punë. Nuk më kujtohet thika ku ka qen, as që e kam goditur Z. me thikë a jam fajtor a jo nuk më kujtohet. Thika i është

prezantuar në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të veçantë dhe e ka pranuar se është e tij duke e quajtur brisk .

Mbrojtësi i të akuzuarit gjatë tërë procedurës por edhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se i akuzuari veprën penale e ka kryer në gjendjen e paaftësisë së plotë mendore së paku thirrej në nenin 18 par 1 të KP të Kosovës dhe pretendimet se duhej të caktohej në vend të dënimit me burgim vetëm trajtimi i detyrueshëm psikiatrikë meqenëse sipas të gjitha rrethanave në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë person me paaftësi të plotë mendore, se vepra nuk është kryer me dashje.

Gjykata gjatë procedurës së provave, analizës së tyre të të gjithave së bashku por edhe të secilës veç e veç gjeti se i akuzuari me të vërtet ka kryer veprat penale që i vëhen në barrë me aktakuzë por në gjendjen e përgjegjësisë penale esencialisht të zvogëluar:

1.Ashtu që me datë 23. 10. 2015 rreth orës 21:25 minuta në S., në shtëpinë e tij familja e cila gjendet në rrugën ... me dashje privon nga jeta anëtarin e familjes bashkëshorten Z. B. në atë mënyrë që pas një bisede dhe mosmarrëveshjeje paraprake lidhur me do telefonat që i merrte bashkëshortja e tij për të cilat besonte se kanë të bëjnë me tradhti bashkëshortore , deri sa viktima Z. B. ishte në dhomën e ndejës dhe bisedave rreth kësaj çështje, me një thikë të gjatësisë së tehut 10.5 cm, e gjerësisë 2.5 cm e sulmon bashkëshorten me thikë duke i shkaktuar njëzetë ( 20) plagë, prej tyre dymbëdhjetë ( 12) plagë kanë qenë depërtuese, shtatë ( 7 ) goditje ka pësuar në zgavrën e majtë të kraharorit dhe pesë ( 5 ) goditje në zgavrën e barkut, vajza e tyre e mitur E. B. pas britmave të nënës hyn në dhomën e ndejës dhe sheh se babai N. B. është duke e goditur me thikë nënën Z., i afrohet ta mbrojë nënën duke vendosur dorën e djathtë në trupin e nënës me këtë rast e godet me thikë në dorë edhe të dëmtuarën E. B., me ç rast nga plagët e marra e ndjera Z. B. vdes në vend si pasoj e gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme nga dëmtimi i mushkërisë së majtë, mëlçisë, shpretkës, majës së zemrës, të gjitha këto plagë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë dhe me maje, më për së afërmi e përshkruar si në raportin e autopsisë të dt. 25.10.2015 të ekspertit mjeko – ligjor dr. Sci F. B., ndërsa të dëmtuarës vajzës E. B. i shkakton lëndime të lehta trupore në regjionin e shuplakës të dorës së djathtë – në gjendje të përgjegjshmërisë penale të zvogëluar,

-kësodore kryen veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par 1 pika 1 .3 188 par 3 nën par 4.2 lidhur me par 2 të KP të Kosovës, dhe

2. Se me datën, kohën dhe vendin e njëjtë i akuzuari i shkakton lëndim të lehtë trupor vajzës së mitur të dëmtuarës së ndjeshme E. B. me një mjet të rrezikshëm dhe të mprehtë me të cilën mund të shkaktohet lëndimi i rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit në atë mënyrë që pas britmave të nënës Z. E. hyn në dhomën e ndejës dhe sheh se babai N. B. është duke e goditur me thikë nënën Z., i afrohet ta mbrojë nënën duke vendosur dorën e djathtë në trupin e nënës me këtë rast i akuzuari N. e godet me thikë në shuplakën e dorës së djathtë duke i shkaktuar plagë prerëse e cilësuar nga eksperti mjeko-ligjor dr. M. G. të dt. 28.01.2016 së lëndimi i lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin-në gjendje të përgjegjshmërisë penale të zvogëluar,

- kësodore kryen veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 3 nën par 4.2 lidhur me par 2 të KP të Kosovës.

Këtë gjendje faktike gjykata e gjeti pasi që shqyrtoi dhe analizoi provat në këtë çështje penale dhe ate nga deponimi i të dëmtuarës E. B. vërtetohet se në familjen e tyre

nuk ka patur harmoni familjare, pasi që babai disa herë ka përdor dhunë ndaj nënës së saj tani të ndjerës Z. B. por edhe ndaj saj dhe motrave. Për këtë arsye disa herë është lajmëruar në Stacioni policor në S.. Mirëpo natën kritike një herë na ka tubuar edhe ne fëmijëve dhe para të ndjerës Z. B. ka theksuar se nëna kinse po e tradhton me persona të tjerë. Pastaj ne kemi shkua në dhomën tjetër për të fjetur e Z. i ka bërë kafe në një moment kam dëgjuar britmën e nënës “ mos ma mësho “, kur kam hy e kam pa babin me thikë tu e sulmue mamin në pozitën ratë. Unë kam dashur që ta largoj e kam shty babin por nuk kam mundur dhe kam vënë dorën mbi mamin dhe kam ndie se jam goditur me thikë. Motra më e vogël ka hap derën por kur ka pa atë gjendje ka ikë duke e mbyllur derën e dhomës. Pastaj kemi dal jashtë dhe babi më dukej se ka ndjekur motrën tjetër. Nuk janë të vërteta ato që po i thotë babi tani në gjykatë për mamin. Mami imë nuk ka bërë punë të tilla.

Dëshmitarja S. B. nëna e të ndjerës ka deklaruar se vajza e saj Z. prej momentit të martesës me N. B. kur nuk ka qenë e qetë vazhdimisht N. e ka maltretuar fizikisht dhe psikikisht e në disa raste duke e rrahur edhe fëmijët e mitur.

Dëshmitarja H. Sh. po ashtu thekson se N. B. vazhdimisht e ka maltretua dhe e ka rrah Z. por edhe fëmijët. Lajmi se N. e ka plagosur për vdekje Z. e ka marr vesh vonë kah ora 01:30 nga djali i saj i vogël. Z. gjatë takimeve tona që kemi pasur vazhdimisht është ankuar për veprimet e bashkëshortit N. B. për maltremit që po i bënë asaj dhe fëmijëve, Më ka thënë se pa kurrfarë baze po e maltreton dhe nuk ka arsye. Edhe më herët ka konsumuar alkool dhe nuk ka mundur që të kontrolloj sjelljet që ka bërë ndaj motrës Z. dhe fëmijëve. Vazhdimisht ato i ka rrahur dhe sa di unë në bisedë që kam pasur me Z. ajo shumicën e rasteve ka lajmëruar në polici, por ato raste a ka përcjellë policia në Prokurori apo në gjykatë nuk di. Më datë 23.10.2015 Z. më ka thirr në telefon në ora 7:30 në mëngjese, më pyeti si jemi dhe më tha që të marr bashkëshortin për me pi kafe. Unë i thashë burrit se na ka thirr Z. me pi kafe dhe ai pranoi. Kështu që bashkëshorti im B. nuk ka shpreh dëshirë të shkoj në shtëpi të N. për shkak se ai ka ditur se sa maltretime po i bënë N., Z. dhe fëmijëve, dhe hatri i Z. ka pranuar që të shkojmë dhe kështu rrethe orës 7:40 minuta kemi qen te ata, ai ka qen duke na pritur neve. Aty ka qen edhe motra, dhe aty kemi konsumu nga një kafe, dhe nuk e kemi parë se i kanë aq raporte të acaruar, bile edhe motra nuk është ankuar në atë drejtim si herave tjera edhe pse ajo ka qenë mëngjesi i saj i fundit që ka qenë në jetë, diku rreth orës 09:00 dhe më pastaj nuk kemi pas kontakt dhe diku në ora 21:25 na tregoi një burrë i motrës S. P. i cili fillimisht ka ardhur së bashku me motrën time E. pasi ka ardhur si mysafirë dhe kur është kthyer në shtëpi ka ndëgju lajmin dhe diku rrethe orës 23:00 është kthyer sërish te na dhe më tha :.. duhesh me marr një injeksion në shtëpinë e shëndetit se tensioni tu ka rit “, atëherë unë i thashë se jam shumë mirë por si po duket Z. i ka ndodhur diçka , unë kam marr injeksionin kam ardh në shtëpi dhe kam pasur vështërsi me tregu nënës, ata në shtëpi krejt kanë ditë vetëm unë nuk kam ditur dhe nëna, e atëherë në mëngjese kah ora 01:30 djali im i vogël më tha nënë bëhu e fortë se te zja Z. ka vdekur nga plagët që ka goditur N. B..

Po ashtu dëshmitari B. Sh. ( përndryshe baxhanak i të akuzuarit) thekson se me datën 23.10.2015 në mëngjes ka shkua me bashkëshorten H. me kërkesë të Z. në shtëpi të saj për të pi çaj edhe pse për një kohë të gjatë nuk ka shkua në shtëpinë e N. për shkak të raporteve jo të mira me te. Edhe ky dëshmitar thekson se N. vazhdimisht ka maltretua Z. dhe fëmijët në momente duke i rrahur ata dhe shkaktuar lëndime. Shton se afër 16 raste N. ka në Polici që Z. e ka paraqitur nga plagët e marra që i ka shkaktuar. Për vrasjen ka kuptuar rreth orës 22:00 të ditës kritike nga baxhanaku tjetër S. P.. Me N. B. e njihem para luftës, por pas luftës na ka lidh edhe puna e miqësore përmes grave me që Z. B. B.

është bagjanakesha dhe se unë personalisht kam qen kundër martesës së Z. me N. B. duke ditur se N. është personalitet negativ konfliktuoz, më herët ka konsumuar alkool, ka qenë i martuar me një shtetase të Gjermanisë me fëmijë e ka larguar nga shtëpia. Martesa e N. B. me Z. gjatë vitit 2000-2001 saktësisht nuk e di datën. Nga ajo martesë këta kanë tre vajza dhe një djal, pas martesës dy deri tre vjet kam pas raporte të mira me N. pastaj duke njohur personalitetin e tij unë i kam ndërpre raportet, ai ka jetu në shtëpinë e tij në S. së bashku me Z.. Por mbas informatave që kam pasur edhe në bisedë të herë pas hershme me bashkëshorten time H. ajo më ka treguar se N. është ka e maltreton ate rregullisht është duke ushtruar dhunë si ndaj asaj po ashtu edhe ndaj fëmijëve. Bashkëshortësia e tyre është bërë e padurueshme dhe mbi gjashtëmbëdhjetë herë Z. ka lajmëruar policin mbi dhunën që ka ushtruar N. asaj dhe fëmijëve dhe në bazë të informatave që kemi dy tre raste a janë përcjell apo jo nuk di. Ka pas raste kur N. e ka lidh Z. në shtëpi dhe ka shku me orë të tëra kur tjerët e kanë gjetur ate të lidhur dhe rrahur nga N.. Pra jetesa e tani të ndjerës Z. me N. ka qenë e padurueshme. Disa herë Z. ka ikur dhe daja i N. e ka kthyer me kusht që N. nuk ka me ngacmu, maltretuar, por N. kur nuk ka mbajtur fjalën. Më datën 23.10.2015 në mëngjese na ka njoftua Z. motrën e vet H. të vijmë për kafe. Trembëdhjetë vite nuk kam qenë në shtëpinë e tyre, atë ditë kam shkuar së bashku me shoqen, na ka pritur mirë aty ka qenë H., unë N. dhe Z., fëmijë e ka largu. Dhe Z. kishte lajmëruar bashkëshorten time H. se me datë 22.10.2015 ka thirr bagjanakun tim F. Th. dhe H. Th. me qëllim që të paralajmëroj motrën e Z. për raporte e padurueshme që ka pasur me N.. Me datë 23.10.2015 në mëngjese në ora 07:30 N. ka vazhdu bisedën me mua dhe më tha : “ është duke u lajmëruar një numër telefoni “ unë thashë pavarësisht që po të lajmërohet mos u ngut se ke grua e ke fëmijë dhe e zbulojmë numrin, kam vërejtur se N. u bo nervoz i bërtiti Z. duke i thënë : “ mbylle gojën lumi i S. nuk ka me të la” dhe unë me te ma nuk kam ndërruar fjalë jam përshëndetur dhe së bashku me bashkëshorten jemi kthyer në shtëpi. N. ka vazhduar dhe ka thirrur motrën tjetër të madhe H. L. me qunin e vet duke i thirr ata në drek . Çka ka bisedu me ta nuk di por di se ata as kafe dhe as drek nuk kanë ngrenë dhe janë larguar. Këto thirrje të atij në mëngjesin e ditës kritike e konsideroj si paralajmërim i ngjarjes tragjike që do të ndodh në atë mbrëmje në shtëpinë e tyre. Rasti se N. e ka goditur bashkëshorten për vdekje me thikë dhe me që e ka plagosur vajzën E. unë kam kuptuar në ora 22:00 nga bagjanaku im S. P. dhe ai më ka njoftuar se N. e ka mbytyr Z.. Atëherë unë kam marr qunin e vogël i cili më ka dërguar me makinë në shtëpinë e Z. me pa rastin, aty ishte policia dhe se ata nuk më kanë lejuar që të shkoj në dhomë deri në ora 00:30 ku erdh automjeti i Departamentit të mjekësisë ligjore dhe e bartën trupin e pa jetë të Z..

Nga Raporti i autopsisë dr. F. B. me nunër të referencës së DML MA 15-301 të datës 25.10.2015 konstatohet se Z. B. ka vdekur si pasojë i gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme nga dëmtimi i mushkërisë së majtë, mëlçisë, shpretkës, majës së zemrës të shkaktuar nga mjeti mekanikë i preftë dhe me maje. Në trupin e të ndjerës janë konstatuar gjithsejtë 20 plagë prej tyre 12 kanë qenë depërtuese në zgavrën e majtë të kraharorit 7 plagë, ndërsa në zgavrën e barkut 5. Plagët janë të lokalizuar kryesisht në anën e majtë të trupit.

Nga Raporti i ekspertit mjeko ligjor dr. M. G. me nr. të referencës Pz-105/16 të datës 28.01.2016 është konstatuar se e dëmtuara E. B. ka pësuar lëndime të lehta trupore plagë prerëse në regjionin e shuplakës së dorës së djathtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin.



Nga provat materiale një thikë me dorëz ngjyrë kafe me gjatësi tehu 10.5 cm dhe gjerësi 2.5 cm për të cilën në seancë N. B. ka theksuar se është e tij dhe vetëm kur kam dal në oborr e kam pa që e kam në dorë përndryshe e njëjta ka qenë në çantën e punës e cila më është nevojitur si vozitës i kamionit kam patur nevojë kur ka patur problem me elektriën për gdhendjen e telave.

Po kështu nga fotoalbumi i Njësitit të Forenzikës të datës 23.10.2015 shihet dhoma në të cilën është kryer vepra penale dhe lista e dëshmive D#1A deri 2.6A të datës 25.10.2015. Vazhdohet me listën e dëshmive të Njësitit të Forenzikës D#1 deri D#11 të datës 23.10.2015 së bashku me tabelën e matjeve nga vendi i ngjarjes me përshkrimin e dëshmive dhe skicimin e vendit të ngjarjes.

Nga fotodokumentacioni shihet se i akuzuari natën kritike ka konsumuar alkool 0.96%promil.

Nga Vërtetimi i Drejtorisë Rajonale Policia në Suharekë nr 04/1-04-S-272015 të datës 20.11.2015 shihet se disa herë e ndjera ka raportuar në Polici për dhunë familjare. Një rast i tillë është i shënuar edhe në Prokurori Publike në Prizren si PP.nr. 133/12 .

Nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Suharekë P.nr.57/2002 të datës 6.06.2002 shihet se i akuzuari është dënuar për veprën penale rrezikimi i përgjithshëm nga neni 48 al 2 lidhur me al. 1 të LPK për shkak se i kishte rrah dhe maltretuar gruan e vetë Z. B., i është shqiptuar dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë)muajsh.

Të gjitha këto prova, fakte e rrethana vërtetojnë se i akuzuari N. B. ka kryer disa herë veprime të dhunës familjare brenda familjes së tij ndaj të ndjerës Z. por edhe ndaj fëmijëve të tij. Disa herë është proceduar para organeve kompetente . Tani në mbrojtjen e tij ai thekson se të gjitha ato veprime që ka ndërmarr ndaj familjarëve kanë qenë që ata të edukohen, të mos marrin rrugë të keqe dhe i ka trajtuar si fëmijë të tij .

Po ashtu gjykatës i janë ofruar prova se i akuzuari edhe më parë ka qenë i trajtuar te specialisti i neurologjisë dr.S. Sh. me datë 02 prill 2008 për çka ka raport ( sg. anksioza-depresive) sikurse edhe raporti specialistikë i datës 24.01.2011 nga dr. Sh. Ç. psikolog, prandaj ka rrjedh edhe kërkesa e mbrojtjes që të bëhet një analizë psikiatrike në Institucionet e Kosovës në mënyrë që të konstatohet me saktësi niveli i përgjegjësisë penale të tij duke patur parasysh mënyrën mjaft të paskrupullt të kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë por edhe sjelljet e tij ndaj anëtarëve tjerë të familjes – fëmijëve. Për këtë qëllim gjykata në fillim ka lëshuar urdhëresë në mbështetje të nenit 508 par 1 e 2 të KPP që i akuzuari të dërgohet në Qendrën e Shëndetit Mental në Prizren në një kontroll për indikacionet eventuale. Qendra e Shëndetit Mental ka udhëzuar se për këtë person se duhet observim stacionar në Institutin e Forenzikës Psikiatrike në Prishtinë në mënyrë që të konstatohet gjendja psikike e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale.

I akuzuari në këtë Institut ka qëndruar prej datës 1 prill 2016 deri më 13 qershor 2016 dhe është trajtuar nga ekipi i ekspertëve dr. F. D. neuropsikiatër, dr. A. V. psikologe dhe dr. Sh. H., psikiatër, të cilët kanë hartuar Raportin e ekspertizës nr. 175/3 me datë 30 shtator 2016 nga i cili konstatohet :

*“...2. Gjatë ekzaminimit janë vërejtur psikosimptome të stresit post traumatik në formë të ndryshimeve, çrregullim të personalitetit si: mos interesim për ndjenjat e të*

tjerëve, mungesë e përgjegjshmërisë dhe mos respektim i vlerave dhe detyrimeve sociale, vështërsi të mëdha në mbajtjen e marrëdhënieve me të tjerët, prag të ulët i tolerancës në situata frustrative të cilat i manifeston me agresivitet dhe dhunë. Ky çrregullim paraqitet në moshë të hershme dhe ka karakter të qëndrueshëm. I njëjti ka histori të sjelljeve dhe raporteve jo të mira me të ndjerën bashkëshorten e tij dhe me të tjerët.

3. Duke marr për bazë natyrën e çrregullimit të personalitetit, mënyrën e përpunimit të informatave ( nën ndikim e madh te xhelozisë ), ndikimi i alkoolit amplifikon përkeqësimin e gjendjes emocionale dhe funksionimin racional, ka rezultuar me reagim impulsiv”

4 .Nga analiza e të dhënave : I njëjti edhe më parë- para rastit, e ka ndërtuar sistemin e dyshimit në bashkëshorten e saj, mirëpo si faktor precipitues dhe përshpejtues, në rrjedhën – dinamikën e ngjarjes ka qenë përdorimi i alkoolit, gjendja e brishtë mendore në përgjithësi, historia e tij. Pastaj akumulimi i afektit dyshimet, pezmi, mërzitja, qëndrimet e tij rigjide, ngarkesat emocionale, energjia negative duke “zbuluar lidhjet” e ish bashkëshortes “me të tjerët “ – në këtë gjendje mendore dhe është kryer vepra e cila i ngarkohet në kurriz.

5 .Tempore criminis, ka qenë në gjendjen të sipër përshkruar ku aftësia për të gjykuar drejtë për rëndësinë e veprës si dhe aftësia për ti kontrolluar ( ndaluar ) veprimet e tij, ka qenë e zvogëluar esencialisht.

6. I njëjti është i aftë për të përballuar gjykimin, deponimet e tij janë valide”.

Konstatimet e njëjta janë nxjerr edhe nga elaborimi gojor i tre ekspertëve në shqyrtimin gjyqësor drejtë për drejtë para palëve.

Siç u tha edhe më parë se kryerja e veprës penale të vrasjes së rëndë me tërë ashpërsinë e saj, brutalitetin e shprehur, pandjesinë e të akuzuarit, nuk kontestohet me asnjë provë që janë administruar në këtë çështje penale madje as nga mbrojtja e të akuzuarit dhe mbrojtësi i tij. Për Gjykatën mbetet të gjejë se cilat dispozita ligjore penale do të aplikohen në këtë rast me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit.

Nga praktika gjyqësore e deri tanishme në Kosovë por edhe nga Doktrina juridike penale si rajonale por edhe Evropiane si Gjermania, Austria etj. rrjedh se te elementet e veprave penale përveç që duhet të vërtetohet gjendja faktike, veprimet kryese dhe të dihet kryesi i veprës penale dhe kauzaliteti i saj ( ana objektive e veprës penale)është e nevojshme që të vërtetohet edhe elementi subjektiv pra raporti i vet kryesit pra raporti mendor i vet kryesit ndaj veprës dhe atë në pikëpamje të vetëdijes dhe vullnetit tempora criminis. Jo vetëm legjislacioni i Kosovës por edhe legjislacionet e rajonit dhe në përgjithësi sistemi kontinental i drejtësisë ( Evropiane) e njohin dhe e përdorin qasjen e tillë në shqyrtimin e çështjeve penale. Po ashtu edhe sistemi anglosakson i drejtësisë (comon law) të cilin e shpreh përmes nocioneve të veçanta si *actus reus* ( kushtet objektive të veprës penale ) dhe *mens rea* ( kushtet subjektive të veprës penale ) si dhe Gjykatat penale Ndërkombëtare në verdiktet të tyre në pjesën e arsyetimeve i marrin parasysh rrethanat e fajësisë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit.

Përkitazi me përgjegjshmërinë penale Kodi Penal i Kosovës në nenin 18 ka paraparë në mënyrë të saktë te paragrafi 1 ku flitet për rastet e personave me paaftësi

mendore ( të plotë) të cilët për shkak se lëngojnë nga sëmundje mendore të përkohshme ose të përhershme nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor dhe si pasojë e kësaj nuk ka qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rendësin apo pasojën e veprimeve ose mos veprimeve të tij, nuk ka qenë në gjendje ti kontrolloj veprimet ose mos veprimet e tij apo të kuptoj se po kryen vepër penale janë persona të papërgjegjshëm penalisht ndaj të cilëve mund të shqiptohen vetëm masa të trajtimit psikiatrikë me ndalim nën ekzistimin e kushteve nga neni 89 i Kodit Penal të Kosovës Trajtimi i detyrueshëm psikiatrikë me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor përcaktohet me dispozitat penale në rrethanat:

- Nëse është fjala për veprën penale që është e dënueshme së paku tre vjet burgim,
- Ekziston rrezik serioz i përsëritjes së veprës penale,
- Kryesi është i paaftë për të përballuar gjykimin dhe
- Është nevoja që të shmanget rreziku serioz.

Me këtë dispozitë neni 18 par 1 Kodi Penal ka vënë kufirin e pa përgjegjshmërisë penale dhe këto praktikisht janë gjendje më të rënda shëndetësore në të cilat personat tërësisht janë të privuar nga elementi intelektual apo vetëdija apo elementi volitiv apo i dëshirës ( vullnetit ) në kryerjen e veprës penale (tempora criminis).

Në par 2 të nenit 18 të KPK përpunohet kategoria e aftësisë së zvogëluar mendore që paraqet kufirin ku fillon përgjegjësia penale edhe pse e zvogëluar me gjithë atë për rrethanat e paragrafit 1 pra të sëmundjeve mendore të përkohshme ose të përhershme, ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionin mendor dhe si pasojë nuk ka qenë në gjendje ti kuptoj natyrën dhe rendësin apo pasojën e veprimeve ose mos veprimeve të tij, nuk ka qenë në gjendje ti kontrolloj veprimet ose mos veprimet e tij në shkallëzimin e zvogëluar edhe pse përsëri ekziston te kjo situatë elementi i vetëdijes i dëshirës por që të dyja këto janë të zvogëluara deri në atë masë sa që të arrihet te përgjegjshmëria penale e kryesve të tillë. Me gjithë atë në situata që gjinden kryesit e veprave penale nga par 2 i nenit 18 të KPK, ka ndikim në ndëshkim madje obligativë ( shih Komentarin e Kodit Penal të Kosovës, prof. I. S., njëri prej hartuesve të dispozitave penale etj. faqe 81, pika 36) nga Gjykata në zbutjen e dënimit duke ia përshtatur nivelit të tyre të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar. Në këtë drejtim Kodi Penal është i çart te neni 18 par 2, fjalia e fundit duke theksuar: “... *Personi i tillë* ( aftësia e të cilit është konstatuar se është esencialisht e zvogëluar për të kuptuar, natyrën, rëndësinë apo pasojën e veprimeve apo mosveprimeve të tij) *konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga Gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm*”. Pa varësisht se në rastin konkret është konstatuar nga ekipi i mjekëve të Forenzikës psikiatrike se këtu i akuzuari N. B. në tempora criminis ka qenë me përgjegjësi penale esencialisht të kufizuar vepra penale është kryer me dashje , me që nivelin e tillë i përgjegjësive penale hynë në zonën e personave përgjegjës penalisht dhe në kuadër të atij niveli të vetëdijes dhe dashjes për veprën ka qenë i vetëdijshëm se po kryen vepër penale të vrasjes i ka dashur dhe ka ditur pasojat në nivelin madje minimal por me gjithë atë ka qenë i vetëdijshëm. Nga përgjegjësia penale përjashtohen vetëm personat që janë (tërësisht të pa aftë mendërisht ) për shkak të rrethanave të përmendura në nenin 18 par 1 të KP (nuk janë përgjegjës penalisht prandaj nuk shpallen fajtor dhe nuk mund të dënohen). Zona e përgjegjshmërisë penale fillon prej nivelit të përgjegjësive së zvogëluar esencialisht penale e jo çdo përgjegjësi të zvogëluar penale (shih komentarin e Kodit Penal të Kosovës prof. I. S. etj. faqe 82 gjendet një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kroacisë i cili në mesin e tjerave

thekson “ *personi me përgjegjësi penale esencialisht të zvogëluar është (plotësisht ) përgjegjës penalisht* “ në nivelin e përgjegjësisë së tij penale).

Duke patur parasysh këto fakte e rrethana të vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor, me prova të argumentuara kjo Gjykatë gjeti se me të vërtetë i akuzuari N. B. ka krye veprë penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 pik.1 p. 3 të KPK dhe lëndim të lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 2 mirëpo në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendjen e përgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar, me që sipas diagnozës së ekipit të Forenzikës ai vuan nga çrregullimet e personalitetit dhe i gjetur përball situatave që i janë paraqitur (të tradhtisë bashkëshortore) ka vepruar në mënyrën më të pa përshtatshme për personat normal duke e privuar nga jeta bashkëshortën e tij si anëtare e familjes dhe duke e lënduar fëmijën e tij të dëmtuarën E. B.. Gjendjes së të akuzuarit çrregullimit të personalitetit i ka ndihmuar konsumimi i alkoolit ditën kritike, afekti i akumuluar, prandaj ka ardhë te veprime impulsive që i akuzuari N. B. të ketë vetëdijen dhe vullnetin të kufizuar (vështërsuar) por të ruajtura dhe të mjaftueshme që të hynë në zonën e përgjegjësisë penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Nuk ka dyshim se vepra e tillë penale ka shkaktuar shqetësim në opinionin e tërësishtëm të Kosovës, por në të drejtën penale gjykohet e dënohet niveli i fajësisë së kryesit duke patur parasysh edhe në rastet kur është shprehur paskrupullësia dhe pandjeshmëri e veçantë e të akuzuarit me rastin e kryerjes së veprës penale, sikurse në rastin që po shqyrtohet mirëpo në këtë rast sipas të gjitha provave e veçanërisht ekspertizës së Institutit të Forenzikës Psikiatrike në Prishtinë është gjet se kryesi ka përgjegjësi të zvogëluar intelektuale dhe volitive për shkak të gjendjes biopsikologjike këto aftësi janë vështirësuar në masë të caktuar por me gjithë atë është në zonën e përgjegjësisë penale prandaj edhe është shpall fajtor në nivelin e fajësisë së tij.

Në këtë drejtim Gjykata e hudhi si të pabazuar dhe të pa mbështetur në prova e rrethana të verifikuara në shqyrtimin gjyqësor tezën e mbrojtjes së të akuzuarit N. B. se nuk ka ditur se si e ka marr thikën në dorë, nuk ka ditur se çka është duke bërë në rastin konkret, pastaj mbrojtësi i të akuzuarit me tezën e tij se i akuzuari në rastin konkret ka qenë me pa aftësi të plotë mendore prandaj në fjalën përfundimtare insistonte që Gjykata të shqiptonte masë të trajtimit të detyrueshëm psikiatrikë me ndalim dhe thirrje në nenin 18 par 1 të KPK gabimisht duke patur parasysh se ky paragraf ka të bëjë me personat tërësishtë të paafte mendërisht për çka nuk flasin faktet dhe provat e veçanërisht ekspertiza e Forenzikës psikiatrike. Kjo pikëpamje e të akuzuarit e mbrojtësit të tij u hodhën si të pabazuara në fakte dhe prova të administruara në shqyrtimin gjyqësor. Vet i akuzuari në mbrojtjen e tij ka theksuar se prej momentit kur ka filluar të dyshoj në thirrje telefonike ka treguar edhe personave të tjerë dhe së bashku me ish bashkëshortën ka shkuar të gjurmohet se kush është personi që po e thirr në telefon bashkëshortën e tij. Madje ai shkon edhe në Polici dhe në Prokurori, rastin e paraqet edhe në Inspektionin e Policisë, para aktit të vrasjes ai ju tregon edhe fëmijëve se kinse nëna e tyre po merret me veprime jo të mira, që tregojnë se ai ka qenë i vetëdijshëm (me kapacitet të kufizuar) në momentin e kryerjes së veprës penale dhe kur dalin fëmijët prej dhomës, pas vazhdimit të bisedave me të ndjerën vjen te njohurit të cilat e bijnë në situatën e përgjegjësisë penale esencialisht të zvogëluar ashtu si e konstaton edhe ekipi i ekspertizës të Forenzikës Psikiatrike, si pasojë e çrregullimit të personaliteti, ndërmerr veprime impulsive, gjendjen e rënduar prej alkoolit, afektit të akumuluar, në momentin e pranimit nga e ndjera se ka qenë në kontakte intime me personin B.S. madje edhe në shtëpinë familjare të të akuzuarit e pikërisht në shtratën ku vet ka patur marrëdhënie të tilla me të ndjerën.

Pretendimi i mbrojtjes se në këtë procedurë mund të shqiptohet vetëm masa e trajtimit të obligueshëm psikiatrikë me ndalim është i gabuar meqenëse ekspertët e Forenzikës kanë deklaruar se ai ka vepruar në gjendje të përgjegjësive penale esencialisht të zvogëluar e cila hynë në zonën e përgjegjshmërisë penale dhe se në këtë moment ka patur dashjen dhe vullnetin në nivelin e zvogëluar me gjithë atë ai ka ekzistuar dhe rrjedhimisht për nivelin e tillë të përgjegjësive ka ditur për veprimet që po i ndërmerr dhe pasojat që do të vijnë prej atyre veprimeve, me gjithë atë me këtë nivel të dashjes i ka ndërmarr këto veprime. Në shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje penale dhe atë në fillim të shqyrtimit kryesor të datës 19.08.2016 (Raporti i Forenzikës por njëkohësisht edhe elaborimi gojor i anëtarëve të ekipit të Forenzikës drejtë për drejtë në seancë) por edhe në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor me datë 21.03.2017 pas ndërprerjes së shqyrtimit të mëparshëm nga shqetësimet e paraqitura shëndetësore nga i akuzuari dhe pas opservimit përsëri në Klinikën e Forenzikës Psikiatrike prej datës 13.01.2017 deri më 09.02.2017 drejtë për drejtë në seancë dr. A. G. psikolog), kanë dhënë konstatimin se i akuzuari është i aftë të përcjell zhvillimin e procesit gjyqësor, të kuptoj akuzat dhe mund të jep mbrojtjen. Gjykata pas marrjes së mendimit nga mjekët e Forenzikës Psikiatrike dhe mendimit të Prokurorit e mbrojtjes ka marr aktvendim se i akuzuari N. B. është i aftë që të përcjell shqyrtimin gjyqësor, të kuptoj akuzat, mund të jep mbrojtjen. Kjo rrethanë është e rëndësishme edhe për shqiptimin e masave të trajtimit të obligueshëm psikiatrikë me ndalim në rase ekzistojnë pengesa të tilla në kohën e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor përkatësisht shqiptimit të aktgjykimit ( neni 511 par 4 i KPP).

Meqenëse pengesa të tilla nuk kanë ekzistuar te i akuzuari, Gjykata nuk ka shqiptuar edhe masën e tillë e cila po të ekzistonin rrethana të tilla ka mund të shqiptohet së bashku me dënimin me burgim dhe kjo vetëm si masë siguroese në rase i akuzuari do të paraqiste rrezik për përsëritjen e veprave penale dhe jo në çdo rast siç pretendonte mbrojtja.

Edhe ekipi i ekspertëve të Forenzikës Psikiatrike ka konstatuar se në gjendjen e tanishme të përgjithshme shëndetësore të akuzuarit nuk propozohet të caktohet trajtim psikiatrikë me ndalim meqenëse do të jenë të mjaftueshme terapitë që jepen në kushtet penitenciare të Kosovës. Më në fund fajësia (përgjegjshmëria) ka funksionin e prezumimeve të ekzistimit të veprës penale (tërësi e prezumimeve subjektive të cilat duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale si përgjegjshmëria, dashja, vetëdija mbi kundërligjshmërinë si legjitimim për dënimin nga shteti dhe funksioni tjetër si një prezumim për matjen e dënimit – faji si bazë dhe masë e dënimit. Këtë funksion fajësia nuk e ka te shqiptimi i masave ndaj sanksioneve tjera e veçanërisht ndaj masave siguroese si në këtë rast masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrikë me ndalim, të cilat parimisht nuk mbështeten në fajësi por në rrezikun nga i pandehuri për përsëritje të veprës penale ose veprimeve të tjera të rrezikshme që priten në të ardhmen ( neni 89 e 90 të KPK). Prej këtij koncepti ka rrjedh edhe parimi i njohur në drejtësinë penale *nula poena sine culpa* ( nuk ka dënim pa faj).

Patjetër se është shumë vështirë të konstatohet përgjegjshmëria esenciale e zvogëluar ose të shkallëzohet, mirëpo kjo nuk mund të jetë shkak që Institucioni i përgjegjshmërisë së zvogëluar të mos merret fare parasysh në çështjet penale. Së pari për shkaqe të drejtësisë dhe humanizmit e drejta penale duhet të ketë parasysh me doemos se të personat mund të ekzistojë gjendje të shumta mendore, të cilat nuk mund të kapen fizikisht ose me shiqim të thjeshtë të shihen, por të cilat me ndihmën e ekspertëve, profesionistëve të lëmive përkatëse mund të konstatojnë se janë persona psikikisht

normal dhe ose jo normal ose diçka të tillë në mes të kësaj. Përveç ekspertizës që është bërë në Institutin e Forenzikës Psikiatrike i akuzuari N. B. edhe para rastit të vrasjes ka qenë pacient i lëmisë së tillë mjekësore.

Trupi gjykues në këto rrethana e ka shpall fajtor të akuzuarin N. B. me që është i përgjegjshëm penalisht (në nivelin e përgjegjësisë penale esencialisht të zvogëluar) se ka kryer veprat penale të cilat i ngarkohen me aktakuzë, mirëpo këtë rrethanë e ka përdor për zbutjen e dënimit në nivelin e përgjegjësisë penale që ka ekzistuar në momentin e kryerjes së veprës penale, duke i shqiptuar dënimin me burgim prej 12 ( dymbëdhjetë ) vitesh për veprën penale të vrasjes së rëndë, ndërkaq dënimin me burgim prej 1 ( një ) viti për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor dhe me bashkimin e dënimeve në mbështetje të nenit 80 të KPK e gjykoj me dënim burgimi unikë në kohëzgjatje prej 12 ( dymbëdhjetë ) vite e 6 ( gjashtë ) muaj duke qenë i bindur se me një dënim të tillë ndaj të akuzuarit në këtë rast do të ndikojë mjaftueshëm në ate personalisht por edhe në rrethinë ku jeton që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet të tilla inkriminuese dhe është i bindur se një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata pati parasysh si rrethanë lehtësuese faktin e përgjegjësisë së zvogëluar penale esencialisht, shprehjen e pendimit të thellë kur tani ka kuptuar se ka shkatërruar familjen e tij, bashkëshorten por edhe fëmijët – vajzat të cilat janë larguar nga i akuzuari si prind i gjallë. Rrethanat rënduese janë evidente dhe të shumta, mënyra e kryerjes së vrasjes është e rëndë, vandale, në opinion ka shkaktuar shqetësim të gjerë, veprimet e dhunshme ndaj familjes edhe para kryerjes së kësaj vepre penale, numri i plagëve të shkaktuara 20 tregon për ashpërsinë e kryerjes së veprës penale dhe qëllimin e tij që me çdo kusht të asgjësoj viktimën të cilën edhe i a ka arritur.

Vendimi mbi paraburgimin u murr në mbështetje të nenit 367 par 2 të KPP, arsyetimi më hollësisht si në kopjen e aktvendimit PKR.nr.10/2016 të datës 12.04.2017.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murr në mbështetje të nenit 453 të KPP ndërkaq në marrjen e sendit në mbështetje të nenit 69 të KPK.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi e në mbështetje të neneve 45, 69, 73 par 3 pika 3.1, 76 par 1 pika 1.1, 80 par 3 pika 7.2 e lidhur me nenin 18 par 2 të KPK dhe nenin 365 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.10/2016 më datë 12 prill 2017**

**Sekretare juridike**  
**Afërdita Buqaj**

**Kryetari trupit gjykues**  
**Xhevdet Elshani**

**UDHËZIM JURIDIKË** - Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, prej ditës së marrjes së të njëjtit. Ankesa i ushtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Prizren.